

**RELACION TEKNIK**  
**(PROJEKT ME PERSHKRIM)**

**Mirëmbajtje me performancë:Librazhd – Fushë Studë – Borovë – Sebisht (35.5) +Urakë - Golik, ( 8.6).  
L= 44.1 km ) ( Kontrata Nr 1 )**

• **Segmentet që mbulon kontrata**

Nr.i rruges	Emërtimi i Segmentit	Koordinatat e fillimit	Koordinatat e mbarimit	Gjatësia km	Gjerësia ml
W46	Librazhd - Zgosht	N 41°11'23.6" E 20°18'31.1"	N 41°26'10.9" E 20°32'07.4"	11.4	8
W47	Zgosht – Borovë - Sebisht	N 41°26'10.9" E 20°32'07.4"	N 41°23'33.7" E 20°25'11.2"	24.1	8
W48	Urakë - Golik	N 41°04'13.4" E 20°35'10.9"	N 41°01'25.2" E 20°31'03.6"	8.6	5
<b>SHUMA TOTALE KONTRATA Nr 1</b>				<b>44.1</b>	

• **Përshkrimi i zonës ku ndodhet rruga**

**Aksi: Librazhd – Fushë Studë – Borovë – Sebisht.**

Në V.K.M Nr.234 datë17.04.2024 ky aks rrugor është pjesë e inventarit të rrugëve nacionale.

Ky aks rrugor ndahet segmente si më poshtë:

**I. Librazhd – Zgosht ( km 0+000 deri km 11+400 )**

Ky është segmenti i parë rrugor që lidh qytetin e Librazhdit me zonën e Peshkopisë

Është segment i rikonstruktuar vitete e fundit ,me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike kanë nevojë për riparime të pjesëshme dhe te vazhdueshme ,

Kanalet anësore dhe tombinot janë ne gjendje te mire me nevojë per mirembajtje te vazhdueshme ,sidomos ne periudhen e shirave pasi shpatet anesore sjellin aluvione.

Gjendja e sinjalistikes eshte e mire por ka nevojë per zvendesimin e tabelave dhe pervijuesve anesore, qe amortizohen dhe demtohen .

Sinjalistika horizontale ne gjendje relativisht te mire por duhen vijëzime të reja.

Rruga ka nevojë për mirembajtjen e guardrails ekzistues dhe vendosjen e guardrails të rinj në vendet me nevojë

Rruga ka bankina cakulli të alternuara dhe me kuneta betoni shoqeruar me bordure, të cilat duan mirembajtje të vazhdueshme .


Urat , tombinot dhe urat box janë në gjendje të mirë por kanë nevojë të herëpërhershme për pastrime .

Ky aks gjatë periudhës së vjeshtë ka rreshje shiu , gjatë periudhës së dimrit ka rreshje bore ,ngrica dhe në disa vende shkarrje të dherash dhe renie gurresh që ndikojnë në qarkullimin normal të mjeteve, ndaj kërkohet ndërhyrje e vazhdueshme në pastrimin e karexhates.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme, dhe të vazhdueshme.

Në km 3+800 të këtij segmenti ka ndodhur një çedim i rrugës në një gjatësi prej afër 150 ml, për të cilën është njoftuar Supervizori dhe Arrsh, e cila ka dërguar grup specialistësh, pasi duhet të kryhet studim dhe projektim nga ky institucion për arsye se nuk mund të kryhet me fondet e punimeve periodike dhe të

Rruga është në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.  
Niveli i kërkuar i shërbimit të mirembajtjes “i mirë”.





## **II. Zgosht – Borovë – Sebisht : km 11+400 deri në km 35+500**

Në V.K.M Nr.234 datë17.04.2024 ky aks rrugor është pjesë e inventarit të rrugëve nacionale.

Ky është vazhdim i segmentit Librazhd – Zgosht që lidh Librazhdin me zonën e Peshkopisë.


Në këtë segment në datën 01.04.2024 në bazë të kontratës me objekt: “ Sistemim Asfaltim i Rrugës Zgosht – Ura e Çerenecit ( 41.7 km ) fillojnë punimet.

Ky segment rrugor është nën kontratë me FSHZH për 2 vite e 6 muaj duke filluar nga data 01.04.2024.

Llogaritja e kontrates për mirëmbajtje pas dorëzimit nga FSHZH bëhet për 30 ( tridhjetë ) muaj.

Rruga është në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit të mirëmbajtjes “i mirë”.



**Aksi rrugor : Urakë – Golik ( km 0+000 deri km 8+600 )**

Në V.K.M Nr.234 datë17.04.2024 ky aks rrugor është pjesë e inventarit të rrugëve nacionale.

Ky segment rrugor është degëzim djathtas i rrugës nr.Sh 3, Elbasan – Q. Thanë

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje, me gjërrësi të asfaltit 5 m.

Shtresat asfaltike nuk janë në gjendje të mirë , ka shumë çedime të karrexhatës, per te cilat duhet nderhyre me punime komplekse me paketa asfaltike : shtrese çakulli+shtrese binderi + shtrese asfaltobetoni , per rregullimin e tyre

Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm dhe te vazhdueshem.

Gjendja e sinjalistikes eshte e mire por ka nevoje per zvendesimin e tabelave dhe pervijuesve anesore

Sinjalistika horizontale ka nevojë për rifreskim të vijave anësore ne te dyja anet e rruges.

Rruga ka nevojë për mirembajtjen e guardrails ekzistues dhe vendosjen e guardrails te rinj .

Rruga ka bankina cakulli te alternuara dhe me kuneta betoni shoqeruar me bordure


Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme, dhe te vazhdueshme.

Tombinot dher urat box jane ne gjendje te mire por kane nevoje te herepashershme per pastrime .

Ky aks gjate periudhes me rreshje shiu , ne disa vende ka shkarrje te dherash dhe aluvione ndikojne ne qarkullimin normal te mjeteve, ndaj kerkohet nderhyrje e vazhdueshme ne pastrimin e karexhates.

Rruga është në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit te mierembajtjes “i mirë”.





**GRUPI I PUNES**